

FLETË PUNE NGA INFORMATIKA PËR KLASËN 6

Arsimtari: **Xheneta Bela**


Aktivite për periudhë kohore **deri më 27.03.2020**

Lexoni njesine **PROGRAME PËR PUNË ME GRAFIKË** fq. 150-154

Në Windows, programi i thjeshtë për punë me grafikë është **Paint**

Në këto programe mund të vizatohet, të hapen dhe ndryshohen fotografi të gatshme “të zbritura” nga Interneti, ato të fotografuara me aparat digjital etj.

Programi Paint është pjesë e sistemit Operativ Microsoft Windows. Startohet me zgjedhje të Start → Programs → Accessories → Paint.





Pjesët më të rëndësishme të programit të paraqitur në dritare janë:

1. Menyja
2. Shiriti i veglave.
3. Paleta me ngjyra.
4. Pjesa për vizatim

Activate
Go to Setting

SHIRITI ME VEGLA (TOOLBOX)



MENYJA PËR PUNË ME DOKUMENTE (VIZATIME)

- Menyja e programit **File** përmban urdhra për punë me dokument
- Menyja **edit** me urdhra të saj mundëson prerjen, kopjimin, fshirjen dhe vendosjen e pjesëve të selektuara të vizatimit
- Menyja **View** me urdhrat e veta mundëson ndryshimin e pamjes së dritares së punës me kyçje apo shkyçje të shiritave me vegla
- Menyja **Image** mundëson transformime gjeometrike të gjithë vizatimit apo të pjesëve të tij
- Menyja **Colors** mundëson ndryshimin e ngjyrave në paletë.

Activate V
Go to Setting

Tani detyrat e dhëna duhet të punohen në kompjuter në programin Paint

Detyra 1 në programin Paint

Hapni programin Paint dhe ndiqni instruksionet për punë

VIZATIMI ME DORË TË LIRË

Veglat për vizatim me dorë të lirë janë brusha dhe lapsi. Për brushën mund të zgjidhet forma dhe trashësia.

Përpiqu të vizatosh mollë dhe krimb me dorë të lirë me shfrytëzimin e këtyre veglave!

Hapi 1



Vizato me brushë. Zgjedh formë të rrumbullakët dhe madhësinë mesatare. Vizato mollë, e pastaj ngjyrose. Vija e mollës duhet të jetë e mbyllur ashtu që të mos “derdhet” ngjyra.

Hapi 2



Pastaj vizato krimb me formën e njëjtë të brushës, por zmadhoje deri në trashësi të dëshiruar. Me madhësi mesatare të brushës dhe ngjyrë të zezë vizato dy pika si sy të krimbit.

Hapi 3



Mollën e kafshuar mund ta fitosh nëse fshin një pjesë të saj me ndihmën e gomës.

Ruaje vizatimin në flloderin tënd të vizatimeve me emrin ‘molla’. Cilën prapashtesë programi ia shoqëron fajllit.


Detyra 2 në programin Paint

VIZATIMI ME VEGLA ME FORMË TË RREGULLT GJEOMETRIKE

Veglat për vizatimin e formave të rregullta gjeometrike janë veglat drejtkëndësh, shumëkëndësh, elipsa dhe drejtkëndësh i rrumbullakuar. Për secilën vegël mund të zgjidhet trashësia e vijës me të cilën vizatohen format.

Përpiqu me ndihmën e këtyre veglave të vizatosh semafor si në fotografi!

Për vizatimin e vizatimit të ri hapet fajlli i ri me urdhrin nga menyja File →New. Zgjedh trashësi mesatare të vijës për vizatimin e formave gjeometrike!



Hapi 1 Vizato 2 drejtkëndësja.

Hapi 2 Vizato vijat e shtyllës së semaforit.

Hapi 3 Vizato tre forma të rrethit - dritët e semaforit


Hapi 4 Ngjyrose semaforin me zgjedhje të ngjyrës, kovës dhe klik të majtë në sipërfaqen e mbyllur që duhet të ngjyroset.

Ruaje vizatimin në follderin tënd për vizatime me emrin “Semafor”.

KORRIGJIMI I FOTOGRAFISË SË GATSHME KORRIGJIMET ME GOMË

Më së shpeshti korrigjimet në vizatim bëhen me gomë. Goma me madhësi të zgjedhur, kur shfrytëzohet me klik të majtë, në vendin e fshirë e lë ngjyrën e prapavijës.



KORRIGJIMET PRECIZE

Korrigjimet precize të pjesëve të vizatimit bëhen me zumim (zmadhim) të pjesëve që korrigjohen me ndihmën e zmadhuesit (nëpërmjet menysë View  Zoom). Për korrigjimin e pjesës së zmadhuar mund të shfrytëzohet cilado vegël. Korrigjime shumë precize të vizatimit mund të bëhen nëse fotografi a zmadhohet disa herë. Atëherë mund ta ndryshoni ngjyrën e secilës pikë me zgjedhjen e gomës, brushës apo lapsit me dimensione më të vogla



BLLOQE DHE PUNA ME BLLOQE

Pjesët e fotografi së që zgjidhen me veglat për selektim quhen blloqe. Blloqet mund të zhvendosen, fshihen, kopjohen, prehen, rrotullohen në rrafshin horizontal apo vertikal, rrotullohen rreth vetes për kënd të caktuar, zgjaten, shkurtohen, zmadhohen, zvogëlohen etj. Në këtë mënyrë me kombinime të ndryshme mund të bëhen efekte interesante.


FSHIRJA E BLOKUT



Fshirja e bllokut bëhet me tastin Delete të tastierës apo me Edit  'Clear Selection' (Edit  "Delete Selection") nga menyja

PRERJA DHE ZHVENDOSJA E BLOKUT

Bloku nga fotografi a prehet me Edit  Cut të menysë apo me kombinimin e tasteve Ctrl+X të tastaturës. Me Edit  Paste blloku i

prerë vendoset lart majtas në pjesën e dritares për vizatim. Prej atje me klik të majtë -tërheq-lësho bartet në vend të ri. Para prerjes zgjidhet ngjyra e prapavijës e cila do të paraqitet në vendin e bllokut të prerë.

Bloku kopjohet me Edit  Copy nga menyuja apo me kombinimin e tasteve nga tastiera Ctrl+C.






Me Edit  Paste blloku i prerë blloku i prerë vendoset lart majtas në pjesën e dritares për vizatim. Prej atje me klik të majtë -tërheq-lësho bartet në vend të ri. Pasi që njëherë kopjohet blloku ai mund të vendoset me Edit  Paste aq herë sa është e nevojshme.

Detyra e 3 në Paint

DETYRË

VIZATIMI I LULES

Ndiqi hapat për të vizatuar lulen si në fotografi (6)



Activate
Go to Sett

Ndiqni insruksionet per vizatim!

- Vizato rreth.
- Seleктоje. Shkyçe prapavijën. Kopjoje bllokun me Edit ☐Copy.
- Derisa nuk e përfundon lulen përsëriti hapat e mëposhtme.
- Vendose rrethin e kopjuar me Edit ☐Paste.
- Vendose në vendin e duhur me klik tërheq-lësho.
- Kur do të përfundosh edhe me rrethin e fundit, ngjyrose lulen.
- Ruajeni fajllin në follderin e juaj për vizatime me emrin “Lulja”

Detyre shtepie

Përgjigju pyetjeve nga mesimi

- **PROGRAMET PËR VIZATIM fq. 164 pyejtet 1-6**

në fletore të shënohen vetëm përgjigjet .

Vizatimet në programin Piant të fotografohen dhe të dergohen fotografitë me **emër – mbiemër dhe numrin e detyrës.**

Ju dëshiroj punë të mbarë!!